



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE  
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR  
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

**Numri:** KSC-BC-2020-05  
**Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës**

**Vendos:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Pjesëmarrësi parashtrues:** Prokurori i Specializuar

**Data:** 2 tetor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Parashtrimet e Prokurorisë për gjuhën e punës në KSC-BC-2020-05**

---

**Zyra e Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësi për të akuzuarin**  
Julius von Bone

## I. HYRJE

1. Në përputhje me Urdhrin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake,<sup>1</sup> nenin 20 të Ligjit,<sup>2</sup> dhe rregullën 8(3) të Rregullores,<sup>3</sup> Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') paraqet parashtrimet me shkrim për gjuhën e punës në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-05.

2. ZSP-ja parashtron që anglishtja duhet të jetë gjuha e punës në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-05, me përkthim përkatës në shqip, me gojë dhe me shkrim, për të akuzuarin.<sup>4</sup>

## II. PARASHTRIMET

3. Duke mbajtur parasysh tri gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara dhe ZSP-së,<sup>5</sup> ZSP-ja konsideron që caktimi i anglishtes si gjuhë e punës për çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-05 mundëson efikasitetin e procedimit të çështjes dhe pasqyron shpërndarjen praktike dhe të përgjegjshme të kapaciteteve.<sup>6</sup>

4. ZSP-ja ka kapacitete të brendshme të kufizuara për përkthim në serbisht dhe shqip me gojë dhe me shkrim. Këto kapacitete duhet t'u përkushtohen aktiviteteve hetuese në zhvillim e sipër në një numër çështjesh, dhe në përpunimin e provave,

---

<sup>1</sup> Urdhri për parashtrime për gjuhën e punës në KSC-BC-2020-05/F00021, 30 shtator 2020, Publike, ('Urdhri').

<sup>2</sup> Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligji'). Të gjitha referimet 'neni' ose 'nenet' këtu u referohen neneve të Ligjit, përveç nëse është saktësuar ndryshe.

<sup>3</sup> Rregullorja e Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ('Rregullorja'). Të gjitha referimet 'rregulla' ose 'rregullat' këtu i referohen Rregullores, përveç nëse është saktësuar ndryshe.

<sup>4</sup> Neni 21; rregulla 8.

<sup>5</sup> Neni 20; rregulla 8(1).

<sup>6</sup> STL/TSL, *The Prosecutor v. Salim Jamil Ayyash*/Prokurori k. Salim Xhamil Ajash, STL-18-01/I/PTJ, *Décision relative à l'emploi des langues*/Vendim për Përdorimin e Gjuhëve, 22 tetor 2019 para.16; STL/TSL, *The Prosecutor v. Ayyash et al.*/Prokurori k. Salim Xhamil Ajash dhe të tjerëve, STL-11-01/I/PTJ, *Decision on Languages in the Case of Ayyash et al.*/Vendim për Gjuhët në Lëndën Ajash dhe të tjerët, 16 shtator 2011, para.32 ('Duke marrë parasysh sa më lart, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ndonëse tri gjuhët zyrtare të Tribunalit – arabisht, anglisht dhe frëngjisht – gëzojnë status të barabartë, gjithsesi faktori kohor dhe kapacitetet e kufizuara konsideratat ndaj kufizimeve kohore dhe të kapaciteteve, megjithatë, arsyetojnë miratimin e një qasjeje praktike për sa i përket modaliteteve të përdorimit të gjuhës').

përfshirë këtu edhe ato që lidhen me obligimet për dhënien e informacionit tani apo në të ardhmen në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-5 apo në procese të tjera.<sup>7</sup> Devijimi i këtyre kapaciteteve të kufizuara për shqyrtimin e parashtrimeve me shkrim, ose për çështje të lidhura me to, në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-05 do të ishte një barrë e rëndë, me pasoja të mundshme negative për kohëzgjatjen e procesit

5. Disa faktorë të tjerë gjithashtu peshojnë në favor të anglishtes si gjuhë pune. E para, siç është theksuar në Urdhër, krejt procedimi në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-05 deri më sot është zhvilluar në anglishte.<sup>8</sup> Kjo përfshin paraqitjen e parë më 20 tetor 2020, kur i akuzuari pati mundësi që ta përcjellë seancën përmes përkthimit me gojë, shërbim ky që ofrohet nga Zyra Administrative në përputhje me rregullën 8. Për më tepër, z. Julius von Bone, të cilin i akuzuari e ka emëruar si mbrojtës të specializuar të tij,<sup>9</sup> përfaqëson klientin e tij në anglishte gjatë këtij procesi.

6. Caktimi i anglishtes si gjuha e punës në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-05 do të garantojë në këtë mënyrë efikasitetin e procedimit të çështjes dhe, në të njëjtën kohë, të respektojë plotësisht të drejtat e të akuzuarit për t'u gjykuar në një gjuhë të cilën ai e kupton.<sup>10</sup>

7. Për këto arsye, ZSP-ja konsideron që anglishtja duhet të jetë gjuha e punës në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-05, me modalitetet dhe zbatimin praktik aktualisht në fuqi.

**Numri i fjalëve (në anglisht): 529**

/nënshkrim/

**Xhek Smith**  
**Prokurori i Specializuar**

E premte, 2 tetor 2020  
Në Hagë, Holandë

---

<sup>7</sup> *Shih* rregullat 102 dhe 103.

<sup>8</sup> Urdhri, KSC-BC-2020-05/F00021, para.9.

<sup>9</sup> Njoftim për caktimin me kusht të mbrojtësit, KSC-BC-2020-05/F00020, 28 shtator 2020, publik.

<sup>10</sup> Neni 21(4)(a) dhe (g).